

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6209
E shtunë, 9 janar 2021
çmimi 0.40 €

Haradinaj refuzon të paraqitet para Dhomave të Specializuara



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ),
AKTGJYKIMI I KUSHTETUESSES ËSHTË I QARTË

KANDIDATËT PËR DEPUTETË DO TË VERIFIKOHEN NGA GJASHTË INSTITUCIONE



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do të kërkojë nga gjashtë institucione verifikimin e kandidatëve për deputetë të cilët do të garojnë në zgjedhjet e 14 shkurtit. Zëdhënësi i

KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar për gazetën "Epokën e re" se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e

Kosovës për Inteligjencë, Ministria e Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes do ta ndihmojnë procesin e verifikimit të kandidatëve sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme

OPINION

NDRYSHIMI NË KOSOVË VJEN VETËM KUR FILLOJMË TA DUAM MË SHUMË SHTETIN SE PUSHTETIN F. 11

Shkruan: Fadil MALOKU



AKTUALE



TRUMPI NUK DO TË MARRË PJESË NË INAUGURIMIN E BIDENIT F. 2

PESË VIKTIMA DHE 321 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 3

EKONOMI

RIFILLON PUNËN ILIR MURTEZAJ NË POZITËN E DREJTORIT TË ATK-së F. 8

HOXHAJ: DO T'I SANOJMË DËMET NGA PANDEMIA NË SEKTORIN PRIVAT F. 8



SPORT

DERBI NË RAHOVEC F. 12

DRENICA RIKTHEN UKËN, ROGOVËN E MERR NGA VËLLAZNIMI F. 12

PAS RESHJEVE TË MËDHA TË SHIUT, MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME, AGIM VELIU, KA KËRKUAR NGA AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE (AME) NGRITJEN E NIVELIT TË GATISHMËRISË NË NIVEL KOMBËTAR

VËRSHIMET RËNDOJNË GJENDJEN NË DISA KOMUNA

Reshjet e vazhdueshme të shiut dhe të borës në ditët e fundit kanë shkaktuar vërshime dhe vështirësi në qarkullim në disa pjesë të Kosovës. Këto reshje kanë përfshirë disa komuna si dhe fshatra të tyre, duke bërë të pamundur qarkullimin e njerëzve dhe të veturave nëpër rrugë. Vërshimet u kanë shkaktuar telashe edhe bizneseve në disa komuna



DY NJËSI TË FSK-së DO TË MARRIN PJESË NË MISIONIN JASHTË VENDIT

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi nuk do të marrë pjesë në inaugurimin e Bidenit

NJU JORK, 8 JANAR - Presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar se nuk do të marrë pjesë në inaugurimin e presidentit të zgjedhur Joe Biden më 20 janar. Trump e bëri këtë koment në rrjetin social "Twitter". Më herët, Trumpi është zotuar se do të sigurojë një tranzicion të qetë tek administrata e



Bidenit. Trumpi është duke u përballur me thirrjet për një gjykim të dytë, për largim të menjëhershëm nga zyra, pas protestave të dhunshme të mbështetësve të tij, të cilët sulmuan Kongresin më 6 janar. Nga këto ngjarje, pesë persona kanë vdekur, thanë autoritetet amerikane. Më 6

janar Kongresi ishte duke mbajtur një mbledhje të përbashkët për ta certifikuar fitoren e Bidenit në zgjedhje, kur protestuesit u futën në ndërtesë. Pas disa orësh pauzë, Kongresi iu kthye punimeve dhe certifikoi fitoren e Bidenit në zgjedhjet presidenciale të 3 nëntorit të vitit 2020.

Britania miraton vaksinën kundër Covid-19 të kompanisë 'Moderna'

LONDËR, 8 JANAR - Rregullatori shëndetësor në Mbretëri të Bashkuar të premten miratoi për përdorim vaksinën kundër koronavirusit të kompanisë "Moderna". Ministria e Shëndetësisë e

Britanisë ka njoftuar se tashmë janë pajtuar me këtë kompani amerikane që të blejnë edhe dhjetë milionë doza shtesë të vaksinës dhe pret që në pranverë t'i nisin vaksinimet me vaksinën e

"Modernas". Me miratimin e vaksinës së kompanisë "Moderna", në Britani tashmë janë tri vaksina të miratuara, ajo e kompanive "Pfizer/BioNTech" si dhe e Universitetit të

Oxfordit dhe "Astrazenecas", që tashmë kanë nisur të administrohen. Në total, Britania ka siguruar 17 milionë doza të kompanisë "Moderna" dhe dozat e para pritet të vijnë në pranverë.



Udhëtarët në Mbretërinë e Bashkuar duhet të kenë teste negative



LONDËR, 8 JANAR - Të gjithë udhëtarët ndërkombëtarë duhen të kenë teste negative të koronavirusit për të hyrë në Mbretërinë e Bashkuar. Njerëzit që mbërrin me aeroplan, tren ose anije, përfshirë shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar, duhet të testohen deri në 72 orë përpara se të largohen nga vendi ku janë. Sekretari britanik i

Transportit, Grant Shapps, tha se udhëtarët "nuk do të mund të udhëtojnë pa pasur testin negativ". Shapps tha se qeveria "është shumë e etur" për këto masa për shkak të një varianti të ri të koronavirusit, i identifikuar në Afrikën e Jugut. Masat e reja pritet të hyjnë në fuqi në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar javën e ardhshme. Mbretëria e Bashkuar është

vendi më i prekur në Evropë nga koronavirusi, me mbi 2.8 milionë të infektuar dhe mbi 78 000 viktima. Kryeministri britanik Boris Johnson është zotuar se nga 15 janari në Angli do të jepen "qindra-mijëra vaksina" në ditë. Mbretëria e Bashkuar e ka nisur procesin e imunizimit kundër koronavirusit më 8 dhjetor.

OBSH-ja i kërkon Evropës masa më të ashpra kundër koronavirusit

GJENEVE, 8 JANAR - Organizata Botërore e Shëndetësisë u bëri thirrje vendeve evropiane të bëjnë më shumë për të frenuar një variant të ri të koronavirusit i cili është detektuar për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar. Drejtori i OBSH-së për Evropën, Hans Kluge, ka pohuar se duhen masa më të ashpra për ta "rrafshuar vijën

vertikale" të rasteve në disa vende. Ai ka thënë se 22 vende evropiane tani kanë raste të variantit dhe këtë e cilësoi si një "situatë alarmante". Ekspertët e shëndetit thonë se varianti është dukshëm më i transmetueshëm sesa llojet e mëparshme, por jo domosdoshmërisht më i rrezikshëm për të infektuarit.

Ata, gjithashtu, e kanë minimizuar mundësinë që vaksinat të mos jenë efektive ndaj variantit. Në Evropë, vendet me numrin më të madh të të infektuarve janë: Mbretëria e Bashkuar me 2.8 milionë, Franca me 2.7 milionë dhe Italia me 2.2 milionë. Numrin më të madh të viktimave e ka Mbretëria e Bashkuar: mbi 78 000. "Pa



kontroll të shtuar për ta ngadalësuar përhapjen e variantit, do të ketë një ndikim të shtuar në objektet

shëndetësore të cilat tashmë janë nën presion", ka thënë Kluge. Sipas OBSH-së, mbi 230 milionë njerëz në Evropë janë duke jetuar në vende që janë nën izolim të plotë kombëtar. Në të gjithë botën, Covid-19 ka prekur mbi 88 milionë njerëz. Prej tyre, mbi 1.8 milion kanë vdekur dhe mbi 49 milionë janë shëruar.

Erdogani i quan ngjarjet në ShBA "turp për demokracinë"

ANKARA, 8 JANAR - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka thënë se sulmi në Kongresin amerikan nga mbështetësit e presidentit aktual Donald Trump është një turp që ka

"tronditur njerëzimin". Erdogan, i cili ka një miqësi me presidentin Trump, kishte pritur tri ditë para se ta uronte Joe Bidenin për fitoren e tij në zgjedhjet presidenciale të 3

nëntorit. Por, ai nuk hezitoi që t'i dënojë ngjarjet e dhunshme të së mërkurës që, sipas tij, ndodhën në "të ashtuquajturin djep i demokracisë". "Ky është turp për demokracinë.

Shpresojmë që tranzicioni (i pushtetit) të Biden më 20 janar të jetë paqësor dhe se paqja do të kthehet në Amerikë", u tha Erdogan gazetarëve të premtën në Stamboll.



Pesë viktima dhe 321 raste të reja me Covid në Kosovë

Kosova më 8 janar regjistroi edhe pesë viktima dhe 321 raste të reja me Covid-19. Rastet e reja të infektimit dalin pas testimit të 1 648 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 564 pacientë

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 648 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 321 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të personave të vdekur si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga: Mitrovica një rast (86 vjeç), Prishtina një rast (44 vjeç), Prizreni një rast (72 vjeç), Rahoveci një rast (70 vjeç), Vushtrria një rast (76 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 53 264 raste nga 193 944 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 368 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë

shëruar 564 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 45 000 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 896. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 96 raste, Prizren 34 raste, Pejë 22 raste, Gjiilan 18 raste, Fushë-Kosovë 17 raste, Vushtrri 17 raste, Mitrovicë 14 raste, Podujevë 14 raste, Deçan 11 raste, Ferizaj 11 raste, Lipjan 11 raste, Skenderaj 10 raste, Suharekë 9 raste, Malishevë 7 raste, Drenas 5 raste, Istog 5 raste, Gjakovë 3 raste, Viti 3 raste, Kamenicë 2 raste, Klokot 2 raste, Obiliq 2 raste, Rahovec 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Junik, Kaçanik, Klinë dhe Novobërdë.

Rangimi i ri i komunave për Covid-19

Ministria e Shëndetësisë ka bërë rangimin e ri të komunave sipas zonave bazuar në rezultatet e Institutit Kombëtar të



Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), përkatësisht numrin e rasteve të reja të Covid-19 në 100 000 banorë në intervalin kohor prej shtatë ditësh. Nga 8 deri më 15 janar, në zonën e kuqe, janë vetëm shtatë komuna: Prishtina, Fushë-Kosova, Mitrovica e Veriut,

Zveçani, Obiliqi, Zubin Potoku dhe Leposaviqi. Në zonën e verdhë, janë po ashtu shtatë komuna: Mitrovica e Jugut, Ferizaji, Lipjani, Podujeva, Vushtrri, Parteshi, dhe Juniku. Ndërsa, në zonën e gjelbër, janë 24 komuna: Klokoti, Gjakova,

Kamenica, Peja, Drenasi, Skënderaj, Istogu, Deçani, Shtërpca, Klina, Shtimja, Novobërda, Vitia, Prizreni, Suhareka, Kaçaniku, Rahoveci, Malisheva, Hani i Elezit, Dragashi, Mamusha, Gjiilani, Ranillugu dhe Graçanica.

Dy njësi të FSK-së do të marrin pjesë në misionin jashtë vendit

PRISHTINË, 8 JANAR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) pritet që në mars të këtij viti të zbarkojë në misionin e parë paqeruajtës, që nga shndërrimi i saj në ushtri në dhjetor të vitit 2018. Kontingjenti i ushtarëve të Kosovës do të jetë pjesë e misionit të Gardës Kombëtare të Ajovas të Ushtrisë amerikane dhe destinacion i parë pritet të jetë Kuvajti. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka zbuluar më 6 janar se në shqyrtim janë dy vende. "Për vende, i kemi dy opsione, Kuvajtin dhe Irakun, por presim që shumë shpejt ta konfirmojmë këtë. Sado të jetë simbolike, pjesëmarrja jonë është shumë e rëndësishme për FSK-në dhe Kosovën", ka deklaruar Rama. "Radio Evropa e Lirë" ka mësuar nga zyrtarë shtetërorë se opsioni i Irakut është më pak i mundshëm, pasi ky shtet ende nuk e ka njohur Kosovën. Këto detaje janë zbuluar një ditë pasi Kuvendi i Kosovës me 92 vota për dhe asnjë votë kundër miratoi vendimin e 31 dhjetorit 2020 të Qeverisë së Kosovës për


dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në misione jashtë vendit me Gardën Kombëtare të Ajovës. Zyrtarisht ende nuk dihet se sa do të jetë numri i kontingjentit të Kosovës në këtë mision, edhe pse përgatitjet për të ka shumë kohë që kanë nisur. Besa Kabashi-Ramaj, eksperte në fushën e sigurisë dhe inteligjencës, tha për "Radio Evropa e Lirë" se pjesëmarrja pritet të jetë simbolike, por e një rëndësie të veçantë. "Është konfirmuar se njësitë që kanë për të shërbyer bashkë me Forcat e Ushtrisë së ShBA-së, do të jenë nga Mirëmbajtja dhe Logjistika, pra këto janë dy fushat në të cilat FSK-ja do të ndihmojë në kuadër të misionit të përbashkët me ShBA-në", ka thënë Kabashi-Ramaj. Por kjo, sipas saj, nuk e zbeh rëndësinë dhe rrezikshmërinë e misionit. "Të gjithë duhet ta kuptojnë se kjo vjen me rreze, por të gjithë oficerët, nënoficerët e FSK-së e kanë këtë parasysh në momentin që bëhen anëtarë të kësaj force. Kështu që ata janë



shumë mirë të përgatitur që të marrin përsipër edhe rreze të tilla", shtoi ajo. Shumë shtete, duke përfshirë ShBA-në, Britaninë e Madhe, Turqinë, e kanë mbështetur FSK-në me pajisje ushtarake dhe trajnimin e kuadrit të saj profesional. Kosova ka partneritet shtetëror

me Ajovan, Garda Kombëtare e të cilit ndihmon FSK-në në ngritjen e saj dhe konsolidimin në ushtri. Aktualisht, FSK-ja ka 2 747 ushtarë aktivë, ndërkaq synimi është që kjo forcë të ketë 5 000 ushtarë aktivë dhe një forcë rezervë prej 3 000 vetash. FSK-ja deri më tani nuk ka marrë pjesë në operacione

paqeruajtëse jashtë vendit. Në vitin 2018 Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet ligjore për transformimin e mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura. Sipas legjislacionit, është paraparë që procesi i transformimit në Ushtrinë e Kosovës të zgjasë dhjetë vjet.



PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ), AKTGJYKIMI I KUSHTETUESES ËSHTË I QARTË

KANDIDATËT PËR DEPUTETË DO TË VERIFIKOHEN NGA GJASHTË INSTITUCIONE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do të kërkojë nga gjashtë institucione verifikimin e kandidatëve për deputetë të cilët do të garojnë në zgjedhjet e 14 shkurtit.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar për gazetën “Epokën e re” se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Ministria e Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes do ta ndihmojnë procesin e verifikimit të kandidatëve sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme

Ministrinë e Punëve të Brendshme, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Ministri të Jashtme dhe Ministri të Mbrojtjes, për verifikim të kandidatëve sipas nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme”, ka thënë Elezi për gazetën “Epoka e re”.

Ai ka treguar mënyrën se si KQZ-ja do ta bëjë verifikimin e kandidatëve të partive politike nëse ata janë në rregull me ligjin. Sipas tij, do të certifikohen vetëm ata kandidatë të cilët në tre vjetët e fundit nuk janë të dënuar me dënim të formës së prerë. “Në mesin e institucioneve me të cilat KQZ-ja do të bashkëpunojë gjatë kësaj faze të procesit zgjedhor është edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Pra, në këtë institucion do t’i përcjellim listat e të gjithë kandidatëve për të kërkuar verifikim nëse janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në këtë rast me germën Q të këtij ligji, ku përmendet se nuk mund të certifikohet kandidat një person i shpallur fajtor për veprën penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tre

vjetët e fundit”, është shprehur ai.

Më tej, Elezi ka treguar se subjektet politike deri më 16 janar duhet të sjellin në KQZ listat e tyre të kandidatëve. “Subjektet politike, pra këtu përfshihen partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, mund të aplikojnë për t’u certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje deri më 16 janar, në orën 18:00. Pra, deri në këtë kohë subjektet politike duhet t’i sjellin edhe listat e kandidatëve për deputetë”, është shprehur ai, duke shtuar se në bazë të planit operacional të miratuar nga KQZ-ja, ky institucion pret përgjigje për verifikim të kandidatëve nga institucionet që përmenda më lart deri më 20 janar. Sipas Elezit, në bazë të këtij plani është paraparë që listat me emrat e kandidatëve t’u dërgohen më 18 janar.

Zëdhënësi i KQZ-së ka treguar se çfarë ndodh nëse KQZ-ja nuk e certifikon një kandidat për deputet. Ai ka deklaruar se kandidati që nuk certifikohet mund të bëjë ankesë në PZAP. “Pasi t’i kemi pranuar përgjigjet

për verifikim nga këto institucione, Zyra do të paraqesë në KQZ rekomandimet për aprovimin ose refuzimin e certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve. Në rast se ndonjë subjekt politik apo kandidat nuk certifikohet, ai mund të paraqesë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës. Çështja mund të shkojë deri në Gjykatën Supreme nëse pala mund të jetë e pakënaqur me vendimin e PZAP-it. KQZ-ja do të veprojë sipas vendimeve që dalin nga këto institucione”, ka thënë Elezi.

Periodha e ankesave është paraparë të përmbyllet deri më 31 janar, në mënyrë që më 2 shkurt të bëhet e mundur tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e këtyre zgjedhjeve.

Vetëvendosja insiston se Kurti ka të drejtë të kandidojë për deputet

Lëvizja Vetëvendosje insiston se lideri i kësaj partie, Albin Kuri, ka të drejtë të jetë pjesë e listës për

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë me dije se aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese është i qartë sa iu përket kandidatëve për deputetë. Zyrtarët e këtij institucioni kanë treguar për “Epokën e re” se verifikimi dhe certifikimi i kandidatëve për deputetë do të bëhet nëpërmjet disa filtrave të caktuar.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka deklaruar se verifikimi i atyre që ia mësojnë karriges së

deputetit do të kalojë përmes gjashtë institucioneve. “Me qëllim të zbatimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të bashkëpunojë me disa institucione të cilat kanë rolin e tyre gjatë zhvillimit të periudhës së aplikimit/certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Në këtë drejtim, KQZ-ja do të dërgojë kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës,

deputet, pavarësisht se aktgjykimi i Kushtetuese, i cili e ka shpallur të paligjshme qeverinë Hoti, ua ndalon kandidimin për deputet të gjithë atyre që në tre vjetët e fundit kanë një dënim të formës së prerë. Së fundi, nënkryetari i LV-së, Glauk Konjufca, në një emision televiziv ka thënë se Kurti ka të drejtë të jetë pjesë e listës së kandidatëve për deputetë, duke shtuar se kush ia largon këtë mundësi përbën shkelje dhe duhet trajtuar kur të vijë drejtësia në vend.

Ndërsa kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, nuk e ka komentuar deklaratën e Konjufcës. Ajo ka thënë se për KQZ-në aktgjykimi i

Kushtetuese është i qartë. "Për mua aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese është plotësisht i qartë. Gjuha që është përdorur në këtë aktgjykim mund të kuptohet edhe nga ata që nuk janë juristë. Për mua nuk ka asnjë dilemë. Natyrisht se dilemat e komunitetit jojuridik janë të kuptueshme, sepse nuk kanë njohuri të mjaftueshme juridike. Pra, konsideroj se analizat që bëhen nga joprofesionistët vetëm u shkaktojnë dëm qytetarëve të Kosovës", ka thënë Daka për "Top Chanel".

Aktgjykimi i plotë i Gjykatës Kushtetuese ka konstatuar se zgjedhja e Qeverisë së Kosovës, e udhëhequr nga Avdullah Hoti, ishte bërë në mënyrë

Kërkohet largimi nga lista e votuesve e mbi 11 mijë të vdekurve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur të premtën mbledhjen e radhës në të cilën është diskutuar për vlefshmërinë e dokumenteve të votuesve për zgjedhjet e 14 shkurtit. Alim Rama nga Këshilli për Operacione Zgjedhore në KQZ

ka kërkuar që në listat e votuesve të hiqen ata që ende janë të regjistruar me dokumente të UNMIK-ut. Ai ka kërkuar që nga listat e votuesve të largohen edhe personat e vdekur. "Nga shënimet e Departamenteve për Pensione në Ministrinë e

Punës dhe Mirëqenies Sociale, KQZ-ja e ka trajtuar listën e personave të vdekur gjatë vitit të kaluar. Aty ndodhen diku 23 mijë persona. Vitin e kaluar janë konfirmuar 11 mijë e diçka vetë dhe ne kërkojmë që ata të largon nga listat", ka thënë Rama.

jokushtetuese. Në aktgjykim thuhet se një person i dënuar për vepër penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tre vjetët e fundit nuk mund të jetë kandidat për deputet e as të ketë

mandat të vlefshëm në Kuvendin e Kosovës.

Lideri i LV-së, Albin Kurti, së bashku me deputetët e atëhershëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu,

Faton Topalli dhe Donika Kadaj-Bujupi, e cila tashmë është pjesë e AAK-së, më 3 janar të vitit 2018 janë dënuar me kusht për hedhjen e gazit lotsjellës në ambientet e Kuvendit të Kosovës.

HARADINAJ REFUZON TË PARAQITET PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA



PRISHTINË, 8 JANAR - Nënkyetari i Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Nasim Haradinaj, ka refuzuar të marrë pjesë në seancën para Dhomave të Specializuara, ku duhej të deklarohet fajtor apo i pafajshëm lidhur me aktakuzën që ky institucion ka ngritur ndaj tij.

Në seancën e cila u mbajt të premtën në Hagë, pala mbrojtëse e Haradinajt tha se ai nuk do të marrë pjesë në këtë seancë "si protestë për mënyrën se si është trajtuar".

Me këtë rast, gjykatësi i Procedurës Paraprake, Nicolas Guillou, tha se ai do të bëjë deklaram të pafajësisë në emër të Haradinajt "në të gjitha pikat e aktakuzës".

Pas kësaj, pranë Dhomave të Specializuara ka filluar konferenca statusore në rastin e Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucati.

Konferencën statusore, apo konferencën mbi ecurinë e çështjes, e thërret gjykatësi i procedurës paraprake dhe ajo ka për qëllim organizimin e shkëmbimeve ndërmjet palëve. Në këtë konferencë, Prokuroria tregon çfarë lloji të provave ka.

Nga Prokuroria e Specializuara thanë se ata kanë tri paketa me materiale për këtë çështje, duke shtuar se pasi aktakuza është konfirmuar në dhjetor, mbrojtja ka mundur që t'i nisë përgatitjet. Prokuroria tha se 19 shkurti mund të jetë afati për nxjerrjen e materialeve të sekuestruara. Megjithatë, Zyra e Prokurorit të Specializuar tha se nuk pret se nga nxjerrja e materialeve të jetë voluminoze.

Prokuroria kërkon që gjykimi ndaj Gucati dhe Haradinajt të nisë në pranverë të këtij viti, ndërkaq mbrojtja ka kërkuar që të nisë në verë apo në mes të verës.

Avokatët mbrojtës, po ashtu, kanë kërkuar që t'u jepen materialet e sekuestruara gjatë arrestimit të Gucati dhe Haradinajt. Ata kanë thënë se nëse Prokuroria refuzon ta bëjë një gjë të tillë, duhet të tregojë nëse materialet përmbajnë informacion të mbrojtur ose jo.

Prokuroria e Specializuar ka njoftuar se ka 838 faqe materiale dhe 27 materiale audio apo filmike.

Avokatët e Gucati dhe Haradinajt kërkuar së paku një ose dy muaj për t'i kryer hetimet e nevojshme që të mund ta përgatisin mbrojtjen dhe kërkuar që Zyra e Prokurorit të Specializuar ta nisë nxjerrjen e materialeve, përfshirë edhe materialet shfaqësuese.

Gjykatësi Guillo më 11 dhjetor konfirmoi aktakuzën ndaj Haradinajt dhe udhëheqësit tjetër të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës, Hysni Gucati.

Dhomat e Specializuara thanë se aktakuza ka të bëjë me "vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës".

Këto vepra penale dyshohet se janë kryer në periudhën 7-25 shtator 2020.

Sipas aktakuzës, Gucati dhe Haradinaj "zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe nëpërmjet shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale".

Haradinaj dhe Gucati janë arrestuar më 25 shtator në

Prishtinë dhe u transferuan në qendrën e paraburgimit në Hagë. Në muajin shtator të vitit 2020, OVL e UÇK-së tha se ka pranuar në mënyrë anonime dosje që lidhen me Prokurorinë Speciale.

Përmbajtja e tyre nuk është bërë e njohur dhe nuk është konfirmuar nëse ato janë autentike ose jo. Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specializuar në Hagë, që ndryshe njihen si Gjykata Speciale, merren me hetimin e krimeve të supozuara të luftës të pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Deri më tash ky institucion ka njoftuar se ka konfirmuar aktakuzën për krime lufte kundër disa ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në mesin e tyre: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe Salih Mustafa.

Të gjithë këta të fundit ndodhen në objektet e paraburgimit në Hagë.

Pas reshjeve të mëdha të shiut, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka kërkuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) ngritjen e nivelit të gatishmërisë në nivel kombëtar



Vërshimet rëndojnë gjendjen në disa komuna

Reshjet e vazhdueshme të shiut dhe të borës në ditët e fundit kanë shkaktuar vërshime dhe vështirësi në qarkullim në disa pjesë të Kosovës. Këto reshje kanë përfshirë disa komuna si dhe fshatra të tyre, duke bërë të pamundur qarkullimin e njerëzve dhe të veturave nëpër rrugë. Vërshimet u kanë shkaktuar telashe edhe bizneseve në disa komuna

**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 8 JANAR - Reshjet e mëdha të shiut gjatë dy ditëve të fundit kanë shkaktuar vërshime në disa pjesë të Kosovës. Reshjet e dendura të shiut kanë përfshirë Malishevën, Drenasin, Fushë-Kosovën, Gjakovën, Rahovecin dhe Suharekën.

Komuna e Malishevës ka njoftuar se gjendja nga reshjet e shumta të shiut dhe borës është e rënduar, por është e menaxhueshme, edhe pse lumi Mirusha në disa vende ka

dalë nga shtrati. “Si pasojë e reshjeve, disa rrugë janë bllokuar, përfshirë edhe qytetin, ndërsa qytetarët janë duke shfrytëzuar rrugët alternative. Po ashtu, disa ura janë mbuluar nga uji dhe më problematike për qarkullim është rruga Malishevë - Kijevë. Të gjitha ekipet emergjente komunale, së bashku me forcat e rendit, janë në terren dhe situata është duke u menaxhuar, por lusim të gjithë qytetarët që të mos lëvizin pa nevojë, pasi në disa rrugë ka probleme në qarkullim”, ka njoftuar Komuna e

Malishevës.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, së bashku me drejtoritë përkatëse dhe ekipet përgjegjëse të emergjencave dhe të rendit, prej mëngjesit janë në terren për menaxhimin e situatës. Ura në rrugën Malishevë - Kijevë është bllokuar, gjithashtu rruga Mirushë - Gurbardh, te liqeni është bllokuar, rruga në Turjakë, një urë në një lagje në Damanek, pastaj vështirësi ka edhe në rrugën e transitit në Malishevë, në qendër të qytetit, rruga Malishevë - Banjë ka probleme në qarkullim.

Edhe Komuna e Drenasit ka njoftuar të gjithë qytetarët se ekipet emergjente kanë dalë në terren që në orët e hershme të mëngjesit për t'i evituar problemet e shkaktuara nga reshjet e shiut. “Kërkojmë nga qytetarët mirëkuptim dhe bashkëpunim për të tejkaluar këtë gjendje të krijuar nga reshjet e dendura të shiut. Ekipet emergjente janë në terren dhe duke u marrë me të gjitha rastet që paraqiten nga

qytetarët, por kërkojmë prej tyre të kenë durimin dhe mirëkuptim, sepse ne të gjitha rastet do të ketë ndërhyrje nga ekipet emergjente për t'i evituar rastet”, ka njoftuar Komuna e Drenasit.

Uji i kanalizimit dhe shiut vërshon rrugën në Bresje të Fushë-Kosovës

Dega e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK) në Fushë-Kosovë ka bërë me dije se uji i kanalizimit dhe shiut ka vërshuar rrugën në Bresje të kësaj komune. “Ka kohë që banorët në Bresje të Fushë-Kosovës përballen me problem të vazhdueshëm, ku ujërat e zeza dalin mbi sipërfaqe, ndërkohë që gjatë këtyre ditëve shiu ka rënduar edhe më

shumë situatën. Uji i kanalizimit dhe shiut ka vërshuar tërë rrugën. Ndërtesa ku ka shpërthim të kanalizimit dhe grumbullim të ujit nga shiu, e ndan vetëm rruga nga objekti i komunës, por zyrtarëve të korruptuar, nuk iu pengon kjo gjë. Kjo situatë po u shkakton telashe edhe bizneseve në atë pjesë”, ka njoftuar PDK-ja në Fushë-Kosovë. Sipas kësaj partie, gjatë verës era bëhet e padurueshme, kurse gjatë kohës me shi dhe borë uji e merr krejt sipërfaqen e rrugës. “Ankesat e banorëve në drejtim të komunës së Fushë-Kosovës nuk janë marrë parasysh asnjëherë. PDK-ja kërkon nga Komuna e Fushë-Kosovës që të veprojnë urgjentisht për ta sanuar situatën”, ka njoftuar Dega e PDK-së në Fushë-Kosovë.



Komuna e Gjakovës krijon komisionin emergjent pas reshjeve të shiut

Reshjet e dendura të shiut dhe borës kanë vazhduar edhe të premtën në Komunën e Gjakovës. Komuna e Gjakovës ka njoftuar se të gjithë operatorët janë në terren dhe janë duke u munduar që t'i sanojnë problemet. "Sipas parashikimeve meteorologjike, reshjet do të vazhdojnë edhe në ditët vijuese dhe situata të tilla do të mund të na përsëriten. Deri më tani janë raportuar situata të rënduara në hyrjedaljet e qytetit, te rruga 'Qazim Bakalli', tek Ura që lidh Bllokun e Ri me Shkugëzen, kemi bllokim të rrugëve 'Fehmi

Agani' dhe 'Gaspër Karaqi' si dhe paralagja Brekoc. Lusim qytetarët që ta shmangin qarkullimin në këto pjesë", ka njoftuar kjo komunë.

Me vendim të kryetarit të Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, është krijuar komisioni emergjent për verifikimin e situatës së krijuar si pasojë e reshjeve të shiut dhe borës. "Gjatë mbledhjes së këtij komisioni, zyrtarë nga Drejtoria për Shërbime Publike kanë deklaruar se ata së bashku me operatorin ekonomik dhe KRM 'Çabrat' janë gjatë tërë kohës në terren duke sanuar problemet në zona të ndryshme të komunës. Ky angazhim do të vazhdojë edhe më tutje deri në normalizimin e tërësishëm të situatës", ka njoftuar Komuna e Gjakovës.



VELIU KA KËRKUAR NGA AME TA NGREHË NIVELIN E GATISHMËRISË NË NIVEL KOMBËTAR

Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes në terren, ka kërkuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) ngritjen e nivelit të gatishmërisë në nivel kombëtar. "Ministria e Punëve të Brendshme përmes AME-së me vëmendje të shtuar po e përcjell gjendjen aktuale të vërshimeve të pjesshme si pasojë e reshjeve të shiut. Deri më tani në Komunën e Gjakovës, Malishevës, Rahovecit, Drenasit dhe Suharekës ka pasur vërshime të

pjesshme, derisa ekipet e AME-së janë në terren duke vepruar sipas nevojës dhe rrethanave. Në komunat e tjera situata momentalisht është e qetë dhe nën kontroll. AME do t'i koordinojë të gjitha veprimet operacionale me shtabet komunale, për të ndërhyrë aty ku është e nevojshme, por edhe për t'i ndihmuar këto shtabe si me personel ashtu edhe me mjete. MPB-ja do t'i informojë qytetarët në rast të përkeqësimit të gjendjes aktuale", ka njoftuar MPB-ja.

Instituti Hidrometeorologjik kishte paralajmëruar për vërshime

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës më 6 janar kishte paralajmëruar për vërshime të shpejta në vendin tonë. "Reshjet e shiut, të cilat pritet të fillojnë gjatë orëve të pasdites së datës 06/01/2021, me intensitetet master deri të lartë, fillimisht do ta përfshijnë pjesën perëndimore të vendit (zonën malore të Alpeve Shqiptare), të cilat në vazhdim do ta përfshijnë rrafshin e Dukagjinit dhe pjesë të tjera të vendit. Kjo situatë do të vazhdojë për disa ditë (09/01/2021), ku si pasojë e intensitetit më të lartë të tyre, në disa zona mund

të paraqiten vërshime të shpejta, të cilat potencialisht shkaktojnë ngritje të shpejta të nivelit të ujit nëpër lumenj e sidomos nëpër rrjedhat ujore të cilat kanë karakter të rrëkeve", ka njoftuar IHK-ja.

Sipas këtij instituti, nëpër lumenjtë kryesorë do të ketë ngritje të lehtë të niveleve gjatë ditëve në vijim, ndërsa rrjedhat me karakter malor dhe ato të rrëmbyeshme do të paraqesin mundësi të vërshime të shpejta dhe vështirësi nëpër zonat/vendbanimet ku ato kalojnë.



Policia bën thirrje për kujdes në trafik

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Policia e Kosovës (PK) ka njoftuar se, bazuar në detyrat dhe autorizimet e saj ligjore dhe kushtetuese, është e përkushtuar për mbajtjen e rendit, garantimin e sigurisë publike si dhe menaxhimin dhe kontrollin e trafikut rrugor nëpër të gjitha rrugët e vendit. "Policia e Kosovës sipas planifikimeve operacionale, parasheh aktivitete të shtuara me qëllim që të paran-

dalohen aksidentet dhe të rritet siguria në trafik, pasi nga të reshurat atmosferike zvogëlohet dukshmëria dhe paraqiten vështirësi në qarkullimin rrugor. Andaj, përveç aktiviteteve policore në këtë aspekt, Policia e Kosovës apelon tek të gjithë pjesëmarrësit në trafik që të kenë kujdes më të shtuar, t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e trafikut rrugor si dhe t'u përshtaten kushteve të rrugës dhe atyre atmos-

ferike, për të pasur një siguri më të madhe në trafik përgjatë sezonit dimëror", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Po në këtë njoftim është theksuar se "për të gjithë ata pjesëmarrës në trafik, e në veçanti për drejtuesit e automjeteve të cilët bëjnë shkelje të ligjeve e rregullave të trafikut, Policia e Kosovës do të ndërmarrë masa ndëshkuese sipas ligjeve në fuqi".



Hoxhaj: Do t'i sanojmë dëmet nga pandemia në sektorin privat



Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka thënë se PDK-ja si parti e qendrës së djathtë, në qendër të programit zhvillimor e ka vendosur mbështetjen për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat paraqesin shtyllën kryesore të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Gjatë takimit me 40 ndërmarrës të bizneseve të sektorëve të ndryshëm, Hoxhaj ka premtuar se me ardhjen e PDK-së në qeverisje do të sanohen dëmet nga pandemia në sektorin privat

ekonomik të PDK-së dhe të qeverisë që do ta udhëheqim. Natyrisht se ne e kemi një vizion të qartë se çfarë po ndodh me zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kam marrë ide dhe propozime konkrete nga bizneset dhe PDK-ja do të dalë me program të plotë ekonomik për sektorin privat, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që janë shtyllë e zhvillimit ekonomik dhe do të bëj përpjekje që këto kërkesa të jetësohen në 100-ditëshin e parë”, ka thënë Hoxhaj.

Ai ka thënë se qëllimi i këtyre masave është eliminimi i procedurave burokratike për bizneset, sidomos për krijimin e bizneseve të reja, duke krijuar një skemë e cila ka për synim ta mbështesë kryesisht ndërmarrësinë të rinjtë. Po ashtu, ai foli edhe për mbështetjen e punëtorëve në sektorin privat, për trajtimin e dinjitetshëm dhe për mbrojtjen me ligj të të drejtave të tyre. Sipas tij, përmes këtyre masave

synohet të bëhet financimi i programeve të ndryshme të edukimit dhe të trajnimit për ndërmarrësit dhe për personelin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me qëllim të rritjes së kulturës ndërmarrëse dhe të pajisjes me njohuri rreth praktikave moderne të menaxhimit.

PDK-ja do ta rikthejë Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka vizituar kompaninë “Vision Agency”. “Ishte kënaqësi ta nisë ditën me një vizitë në Kompaninë ‘Vision Agency’, e cila edhe gjatë pandemisë ka krijuar vende të reja të punës dhe ka pasur një bilanc pozitiv në eksport. Fazli Kabashi, një atdhetar që jeton në Zvicër, është

kthyer në Kosovë dhe ka investuar në këtë kompani, që ua ka hapur dyert rreth 300 të rinjve për t’u zhvilluar në fushën e telemarketingut dhe në sisteme kompjuterike digjitale”, ka thënë Hoxhaj pas kësaj vizite.

Hoxhaj ka pohuar se si kryeministër i Kosovës dhe si PDK prioritet do ta kenë fuqizimin e këtij sektori inovativ sepse, sipas tij, Kosova ka potencial ta zhvillojë, duke pasur popullatën më të re në rajon. “Është për të ardhur keq që qeveritë e kaluara, LV-ja dhe LDK-ja, e shuan Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë të cilën ne e krijuam pikërisht për ta mbështetur këtë sektor dhe për ta shndërruar Kosovën në një vend me perspektivë për të rinjtë. PDK-ja do ta rikthejë ministrinë dhe do të zhvillojë projekte konkrete për kompanitë vendore si dhe do ta bëjë Kosovën vend tërheqës edhe për kompani të huaja”, ka deklaruar Enver Hoxhaj.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

SUHAREKË, 8 JANAR - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, bashkë me kryetarin e Degës së PDK-së në Suharekë, Ramë Vataj, ka takuar të premtën përfaqësuesit e Shoqatës së Bizneseve në këtë qytet.

Gjatë takimit me 40 ndërmarrës të bizneseve të sektorëve të ndryshëm, Hoxhaj ka thënë se PDK-ja si parti e qendrës së djathtë në qendër të programit zhvillimor e ka vendosur mbështetjen për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat paraqesin shtyllën kryesore të zhvillimit ekonomik të Kosovës. “Ishte kënaqësi t’i takoj ndërmarrësit e Suharekës dhe të bisedoj me ta për programin

Rifillon punën Ilir Murtezaj në pozitën e drejtorit të ATK-së

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Nga dita e premtë Ilir Murtezaj ka rifilluar punën në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, bazuar në vendimin nr. 302/2020, të marrë nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, për rikthimin në pozitën e drejtorit të

përgjithshëm të ATK-së, Ilir Murtezaj. Andaj, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit që ka drejtori i përgjithshëm i ATK-së, drejtori Murtezaj ka mbajtur takimin e parë me menaxhmentin e lartë të ATK-së për këtë vit, në të cilin janë diskutuar planet dhe aktivitetet për vitin 2021,

si dhe shumë projekte të tjera të cilat do të vazhdojnë të finalizohen gjatë këtij viti. Drejtori Murtezaj fillimisht uroi menaxhmentin që ky vit të jetë vit i mbarë për të gjithë, njëherësh uroi që efektet e pandemisë këtë vit të jenë të riparueshme në të gjitha segmentet ku ATK-ja ka rolin e saj.



Ministria e Infrastrukturës: Kompanitë kanë intervenuar për heqjen e borës nga rrugët

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 JANAR - Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se pas reshjeve të shiut në drejtim të autoudhës Vermicë - Gjurgjicë, në kilometrin e 53-të, ka pasur rrëshqitje të dheut, të një sasive jo të madhe, por që autoudha "Ibrahim Rugova" është e qarkullueshme.

Ministria e Infrastrukturës ka bërë me dije se ka sinjalizuar vendin dhe ekipet janë duke

punuar për ta sanuar gjendjen. "Gjatë natës të së enjtes në disa regjione ka pasur reshje bore, por kompanitë e mirëmbajtjes kanë intervenuar për pastrim të borës dhe për shpërndarje të kripës sidomos në regjionin e Pejës e të Gjakovës si dhe në viset malore. Autoudha R6 Doganaj-Hani i Elezit, autoudha A6 Konjuh-Doganaj, regjioni i Ferizajt 1 dhe Ferizajt 2, si dhe Prishtina 2 janë krejtësisht të lira për qarkullim", ka njoftuar

Ministria e Infrastrukturës. Ndërsa në regjionin e Gjilanit 2 gjendja e rrugëve është e mirë, ka pasur reshje shiu dhe në vendet me lartësi më të lartë ka mjegull. "Te Gjilani 2 të gjitha rrugët janë në gjendje të mirë, në disa pjesë për shkak të reshjeve të shiut ka erodime, por që rrugët janë të kalueshme. Po ashtu, është intervenuar në shpërndarjen e kripës në rrugët: Prizren-Prevallë, Zhur-Dragash-Restelicë, Dragash-Brod. Në regjionin Peja 1, ka reshje të

borës me intensitet të lartë, po ashtu ka intervenime në largimin e borës dhe shpërndarjen e kripës në të gjitha rrugët që janë nën përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës", ka njoftuar kjo ministri.

Po ashtu, Ministria e Infrastrukturës është intervenuar me kripë në rrugët: Prishtinë-Mutivodë (segmenti Stallovë-Mutivodë), QMI-Carralevë (segmenti Shtime-Carralevë) dhe Komoran-Carralevë (segmenti Salë-

Carralevë).

Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se bashkë me Policinë e Kosovës dhe kompanitë e mirëmbajtjes janë në terren 24 orë për t'i mbikëqyrur rrugët e Kosovës dhe për të mundësuar qarkullim normal. "Për shkak të reshjeve të mëdha të shiut, Ministria e Infrastrukturës apelon te të gjithë qytetarët që të kenë kujdes të shtuar dhe t'i kenë veturat me pajisje dimërore", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.



Prodhuesit kërkojnë fond për zhvillim ekonomik dhe subvencionim të eksportit

PRISHTINË, 8 JANAR - Pandemia Covid-19 gjatë vitit 2020 ka shkaktuar probleme të shumta në ekonominë e vendit. Shumë biznese u shuan e shumë të tjera punuan vetëm për mbijetesë. Vështirësi të ndryshme pati edhe kompania "Fluidi" nga Gjilani, sidomos për plasmanin e produkteve në treg dhe për eksportin drejt vendeve të BE-së.

Drejtori i kësaj kompanie që merret me prodhimin e pijeve joalkoolike dhe energjike, Fejzulla Mustafa, në një intervistë për "KosovaPress" thotë se masat kufizuese për parandalimin e Covid-19 ndikuan në rënien e të hyrave, megjithatë shton se nuk kanë larguar asnjë punëtor dhe as nuk i kanë zvogëluar pagat e tyre. Mustafa thotë se kjo



kompani ka rreth 200 punëtorë dhe, përveç ndihmës nga pakoja e parë për rimëkëmbje

ekonomike, nuk kanë gëzuar asnjë lloj ndihme tjetër nga Qeveria e Kosovës. Ai shton se

gjatë kësaj periudhe janë detyruar të hyjnë në kredi në bankat komerciale. Ai thotë se

institucionet e vendit duhet të krijojnë një fond për zhvillim ekonomik, por edhe ndonjë subvencionim të eksportit, me ç'rast do të mundësohej plasimi më i lehtë i produkteve vendore në tregun ndërkombëtar. "Qeveria duhet të krijojë një fond për zhvillim ekonomik dhe t'u mundësojë bizneseve kredi me interes të ulët dhe me kohëzgjatje më të madhe pa ndonjë interes", ka thënë Mustafa.

Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës duhet t'i mbështesë bizneset dhe prodhuesit vendorë në forma të ndryshme, në mënyrë që të mos bie prodhimi dhe të mos zvogëlohet numri i të punësuarve që do të ndikonte drejtpërdrejt në ekonominë e vendit.

Sekuestrohet një armë zjarri me municion në Prishtinë

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë po ndërmerr të gjitha masat e nevojshme policore për ta siguruar rendin dhe qetësinë publike në rajonin e Prishtinës. Në kuadër të veprimeve operative që po kryen policia me qëllim parandalimin dhe zbulimin e veprave kriminale, më 7 janar, rreth orës 20:30, në dalje të

Prishtinës ka ndaluar veturën "Golf" me targa të Kosovës. Marrë parasysh vendin si dhe rrethanat në të cilat ishte ndaluar vetura, policia kishte ushtruar një kontroll të hollësishëm ndaj personave dhe veturës me ç'rast ka arritur që të gjejë dhe të sekuestrojë një revole të tipit COLT, shtatë copë fishekë, kalibër 45 mm, si dhe një

këllëf revoleje. "I dyshuari K. D., mashkull, 29 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës, është shoqëruar në stacionin policor dhe ndaj tij është iniciuar rasti për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës, dhe në konsultim me prokurorin e shtetit, i njëjti është proceduar më tutje", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Arrestohen tre persona në Istog për 'vjedhje të rëndë në tentativë'

ISTOG, 8 JANAR (ER) - Policia e Kosovës, Stacioni Policor në Istog, më 08.01.2021, në orën 01:55, ka pranuar informatë nga një qytetar, se në rrugën "Fehmi Agani" në Istog disa persona janë duke tentuar ta thyejnë derën e një depoje. "Menjëherë patrulla policore iu ka përgjigjur rastit dhe në vendngjarje ka arritur ta arrestojë njërin nga të dyshuarit, gjersa dy të dyshuarit e tjerë kanë arritur të largohen nga vendi i ngjarjes. Policia u është vënë pas dhe pas një kohe të shkurtër, ka arritur t'i arrestojë edhe dy të dyshuarit. Njësi i Hetimeve pranë Stacionit Policor në



Istog, në vendin e ngjarjes ka gjetur dhe konfiskuar një 'kaqavidë'. Të dyshuarit, pas intervistimit, me vendim të

prokurorit të shtetit, u është caktuar masa e ndalimit prej 48- orësh", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Bulliqi i ofron përkrahje Shoqatës 'Handikos'

PODUJEVË, 8 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e Shoqatës "Handikos" në Podujevë.

Bulliqi me përfaqësuesit e "Handikosit" ka biseduar për funksionimin e kësaj shoqate dhe mbështetjen që i ofron komuna. Me këtë rast

përfaqësuesit e "Handikosit" e uruan kryetarin Bulliqi për marrjen e mandatit në krye të komunës dhe kërkuan mbështetje për projekte të ndryshme të shoqatës.

Kryetari Bulliqi ka premtuar se do të angazhohet për mbështetje të kësaj shoqate e cila ofron shërbime dhe përkrahje për personat me nevoja të veçanta.



Rrugët në Klinë, në gjendje të mirë dhe të kalueshme

KLINË, 8 JANAR (ER) - Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, ka njoftuar se pas reshjeve të borës, kompania e kontraktuar nga komuna për mirëmbajtjen e rrugëve që nga ora 03:00 e mëngjesit të së premtes ka filluar pastrimin e të

gjitha rrugëve. "Si rezultat i kësaj, të gjitha rrugët janë në gjendje të mirë dhe të kalueshme, ndërsa aktualisht është duke u punuar edhe për pastrimin e trotuareve", ka njoftuar kjo komunë.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjente, Iber Elezaj, u

ka bërë thirrje vozitësve që të kenë kujdes të shtuar në komunikacion dhe t'i marrin masat e nevojshme mbrojtëse. Ai ka theksuar se ekipet e emergjencave dhe shërbimi i zjarrfikësve janë në gjendje të gatshme për të intervenuar në rast të rrezikut të vërshimeve.

'Air Energy' dhuron dollapë për QKM-në në Kamenicë

KAMENICË, 8 JANAR (ER) - Kompania turke "Air Energy" ka dhuruar donacion i cili përfshinë inventar si dollapë, tavolina dhe perde për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kamenicë dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare në Hogosht. Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Suna Zajmi-Krasniqi,

ka falënderuar këtë kompani për këtë donacion, duke thënë se donacionet e tilla rrisin kapacitetin në institucionet shëndetësore. "Falënderoj kompaninë 'Air Energy' për këtë donacion i cili është i nevojshëm për institucionet tona shëndetësore. Duke rregulluar infrastrukturën në institucionet tona, pa dyshim që rritet kapaciteti dhe cilësia e punës", është shprehur ajo.



Ndryshimi në Kosovë vjen vetëm kur fillojmë ta duam më shumë shtetin se pushtetin

Ndryshim s'ka aty ku qytetari dridhet para politikanit injorant, por aty ku politikanin gjumi s'e merr nga detyrimet dhe obligimet qytetare



Shkruan: Fadil MALOKU

1. Koha në të cilën po bashkëjetojmë, pra në një demokraci ende të brishtë dhe të pakonsoliduar sa dhe si duhet në kuptimin e krijimit të një sigurie e stabiliteti politik e, para së gjithash, sigurie ekonomike, krijimi i qeverive të reja në Kosovën e pasluftës në pothuajse shumicën e rasteve ishte më

shumë prodhim i koalicioneve në mes të liderëve (konformist dhe poltronist ndaj ndërkombëtarëve!) shumë të fuqishëm sesa i programeve ideologjike dhe nevojave faktike sociale dhe ekonomike të vendit. Në fakt, në këtë proces të formimit të qeverive, zakonisht apo të paktën përvoja na ka dëshmuar se këto koalicione tipike me frymë dhe filozofi të sjelljes dhe veprimeve klanore, e kishin më shumë funksionin dhe synimin e grabitjeve dhe monopoleve të (ri)ndërtuara për klanin dhe grupimin e vet (jo)ideologjik sesa interesin e njëmendët shtetëror dhe protagonizimin e demokracisë qytetare për vendin...

2. Por, pse ndodhi kështu, shtrohet pyetja sociologjike? Arsyet mund të jenë të shumta, por një analizë më e thukët doemos do të prodhojë një bindje tjetër fare që pak a shumë duhet të ndërlidhet edhe me rrethanat dhe proceset nëpër të cilat ka kaluar në ndërkohë procesi i shtetndërtimit të Kosovës. Në fakt, ishte monitorimi (për të mos thënë ndërhyrja!) e mekanizmave ndërkombëtarë, përvoja e shkurtër në demokraci (kalimi prej një sistemi tipik komunist), inatet dhe xhelozitë e dala nga lufta (krahu i luftës, krahu i paqes), detyrimet e privatizimit (interesat e korporatave të mëdha për ta blerë sa më lirë pasurinë shoqërore), krimi i organizuar (të

gjitha të dhënat e Transparency International, kanë folur për një shkallë të lartë krimi të ndërlidhur po me këto elita politike), korrupsioni (gjithashtu i dëshmuar nga sektori i shoqërisë civile lokale dhe asaj ndërkombëtare etj.) ato problemet përcjellëse që e ngadalësuan "bioritmin" e demokracisë.

3. Probleme dhe situata këto, të ndodhura dhe të testuara aq sa mund të thuhet se shërbyen më shumë si "argumente" sesa si ndonjë "alibi" konstante (jo për t'i amnistuar sjelljet e kastës politike, e as për t'i gjetur "arsyetimet që mund të jenë edhe banale!") në krejt angazhimin tonë për ngrehinën e asaj populistët e

identifikojnë si "etikë përgjegjësie" për shtetin, institucionet, demokracinë etj. Por, kjo mënyrë këndvështrimi kësaj nuk nënkupton domosdoshmërisht se tani ne si shoqëri dhe si qytetarë demokratë dhe të emancipuar politikisht, që kemi bërë sado kudo një përvojë në ndërtimin e kapaciteteve demokratike institucionale, duhet ta vazhdojmë avazin e indiferencës dhe pamjaftueshmërisë për t'u interesuar për proceset që do të prodhojnë situatat postzgjedhore. Sepse nuk besoj se do të ndodhë shpejt dhe sigurt ndryshimi (radikal) i dëshiruar dhe i shumëpritur nga qytetaria e Kosovës.

Edhe dy të lënduar nga bombola e gazit do të dërgohen për shërim në Austri




Ferizaj, 8 janar (ER) - Komuna e Ferizajt ka njoftuar se gjashtë nga të lënduarit e shpërthimit nga bombola e gazit në gjendje më të rëndë janë duke u trajtuar jashtë vendit, katër prej tyre në Turqi, kurse dy të tjerë do të dërgohen shumë shpejt për trajtim në Austri. "Nga shpërthimi në Ferizaj, ku

mbetën të lënduar dhjetëra qytetarë, prej tyre gjashtë në gjendje më të rëndë, sot katër prej tyre u nisën për trajtim shëndetësor në Turqi, kurse dy të tjerët do të nisen së shpejti për trajtim shëndetësor në Austri. Katër të lënduarit që u nisën sot për Turqi po marrin tashmë trajtimin shëndetësor të

specializuar në institucionet shëndetësore turke", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Sipas këtij njoftimi, për dy të lënduarit në gjendje më të rëndë, për të cilët u tha se janë hequr nga lista për trajtim jashtë vendit, bëhet me dije se nuk janë hequr nga lista, por kapacitetet e pranimit në institucionet

shëndetësore turke ishin për katër nga të lënduarit. "Tani, me marrëveshjen që heq shpenzimet e trajtimit shëndetësor nga qeveritë e dy vendeve, dy të lënduarit e tjerë do të nisen për trajtim shëndetësor në Austri. Me këtë rast falënderoj për bashkëpunim ministrin e Shëndetësisë,

Armend Zemaj, Ambasadën e Turqisë, qeverinë austriake që bënë të mundur trajtimin jashtë vendit të qytetarëve tanë. Falënderimi u takon edhe qytetarëve dhe bizneseve për solidaritetin dhe gatishmërinë që të ndihmojnë për shërimin e të lënduarve", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Derbi në Rahovec



RAHOVEC, 8 JANAR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 14-t në Prince Caffë Superligën e Kosovës në basketboll, e fundit për stinorin vjeshtor. Ndeshja kryesore do të zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Golden Eagle Yllit, dy skuadra që janë në formë dhe kanë pasur rivalitet ndërmjet vete. Vreshtarët janë në vendin e parë me dhjetë fitore dhe tri humbje, kurse therandasit në vendin e tretë me tetë fitore dhe pesë humbje. Ndeshjet ndërmjet këtyre skuadrave kanë qenë shumë interesante në vitet e fundit dhe kështu pritet edhe të shtunën. Të shtunën zhvillohet edhe përballja në mes të Pejës dhe Vëllaznimit. Pejanët nuk janë në formën më të mirë të mundshme, megjithatë kanë tetë fitore dhe pesë humbje, kurse kuqezinjët katër fitore dhe nëntë humbje. Ponte Prizreni që u

mposht pas shtatë fitoreve radhazi nga Bashkimi, do të përballet me Trepçën, që është në vendin e fundit me dy fitore dhe 11 humbje. Ndeshja e fundit është ndërmjet rivalëve të vjetër, Sigal Prishtinës dhe Bashkimit. Prishtinasit kanë katër fitore dhe nëntë humbje, kurse prizrenasit shtatë fitore dhe gjashtë humbje.

Bunjaku, MVP i javës 13

Xhiroja e 13-të në Prince Caffë

PRINCE CAFFË SUPERLIGA - JAVA 14

Të shtunën takohen:

15:00 Rahoveci - Golden Eagle Ylli
15:00 Peja - Vëllaznimi

Të dielën takohen:

15:00 Ponte Prizreni - Trepça
17:00 Sigal Prishtina - Bashkimi

Superligën e Kosovës në basketboll ka dhënë disa duele mjaft interesante. Takimin kryesor e ka fituar Golden Eagle Ylli, që ka mundur Pejën me rezultat 89:73. Basketbollisti i Përfaqësueses së Kosovës dhe Yllit, Valon Bunjaku, shënoi 22 pikë në këtë ndeshje, kurse e ndihmoi skuadrën edhe me pesë kërcime, katër asistime, me një indeks prej 24. Kjo nuk është hera e parë që Bunjaku zgjedhet MVP, kurse ka qenë një nga lojtarët më të dalluar të therandasve në këtë edicion, por edhe në atë të kaluar. Ndërkohë, top pesë lojtarët me indeksin më të lartë në xhiron e 13-të ishin Julian Hamati (28) i Bashkimit, Cody John (26) i Golden Eagle Yllit, Cendrik Council (25) i Vëllaznimit, Daniel Lekndreaj (25) i Sigal Prishtinës dhe Valon Bunjaku (24) i Golden Eagle Yllit.

SHKURT

Bytyqi zyrtarizohet te Konyaspori

Futbollisti Zymer Bytyqi është prezantuar në skuadrën e Konyasporit. Lajmin e ka konfirmuar vetë futbollisti në një shkrim publikuar në "Facebook". "Përshëndetje të dashur miq! Dua t'ju njoftoj se nga sot jam lojtar i ri i klubit të madh turk Konyaspor. Klubi ka treguar dëshirë të madhe për të më transferuar dhe kjo gjë ishte e rëndësishme për mua. Faleminderit të gjithëve për mikpritjen si dhe tifozëve të zjarrtë të Konyas që menjëherë më kanë uruar mirëseardhje. Shpresoj t'i arrijmë objektivat që ka klubi", ka shkruar Bytyqi.

Abazi largohet nga Ferizaj

Sulmuesi Armend Abazi është largimi i radhës nga FC Ferizaj. Lojtari e ka konfirmuar vetë futbollistin që dërsiti fanellën e Ferizajt në gjashtë muajt e fundit. "Pas problemeve që ka klubi, kam vendosur të largohem nga Ferizaj", ka thënë Abazi për "Olle".

Muriqi refuzon Galatasarayn

Sulmuesi Vedat Muriqi ia ka mbyllur dyert Galatasarayt, pasi synimi i tij është të qëndrojë përfundimisht në Lazio. Futbollisti "dardan" është takuar me menaxherin e Galatasarayt, Hakan Balta, të cilit ia ka shprehur dëshirën për të qëndruar në Lazio. "Dua të rri në Itali", ka thënë 26-vjeçari. Përvoja e Muriqit në Lazio nuk ishte prej më të mirave deri tash. Ai nuk e ka gjetur ende golin në ndeshjen zyrtare me "Biancocelesti" prej se u transferua nga Fenerbahçe verën e kaluar.

FIFA zhbllokon merkaton e Tiranës

Fillimisht ishte raportuar se Tirana ka probleme me merkaton këtë vit, pasi që FIFA ia ka ndaluar regjistrimin e lojtarëve të rinj për këtë sezon. Megjithatë, gjërat tani kanë marrë një drejtim tjetër. Kështu ka njoftuar klubi i Tiranës, i cili kanë thënë se është zgjidhur përfundimisht çështja e bllokimit të merkatos. Në një komunikatë për shtyp ata tregojnë se pas disa orësh të gjata komunikimi me zyrtarët e FIFA-s, u është bërë me dije se në ditën e sotme është hapur sërish mundësia e transferimit të lojtarëve. "KF Tirana njofton se ka zgjidhur përfundimisht çështjen e bllokimit të merkatos. Pas disa orëve komunikim me zyrtarët të FIFA-s, bëjmë me dije se ditën e sotme është hapur sërish mundësia e transferimit të lojtarëve. Nga sot do të vijojmë të kryejmë të gjitha procedurat e nevojshme për zyrtarizimin e emrave të rinj që do të afrohen në klub dhe do të mbajnë veshur fanellën në vazhdimësi të sezonit", thuhet në njoftimin e Tiranës.

Frashëri dhe Ferreira largohen nga Gjilani

GJILAN, 8 JANAR - Mbrojtësi i krahut të djathtë, Erlis Frashëri, është larguar nga skuadra e Gjilanit. Futbollisti nga Shqipëria në një shkrim publikuar në "Facebook" ka treguar se me skuadrën gjilanasë është ndarë me marrëveshje të dyanshme. "Ju njoftoj se nuk jam më pjesë e skuadrës së Gjilanit. Me marrëveshje të dyanshme arritëm ta ndërpresim kontratën.

Falënderim i përzemërt për drejtuesit e klubit, presidentin Florim Zuka, i cili më ka mbështetur dhe vlerësuar. Falënderim për trajnerin Gentjan Mezani, gjithashtu edhe për Bylbyl Sokolin. Falënderoj grupin e futbollistëve, shokët e skuadrës me të cilët kemi kaluar një vit e gjysmë të shkëlqyer dhe kemi mbështetur njëri-tjetrin në ditë të mira dhe të këqija. Çuna, ju

uroj shumë suksese në ndeshjet në vijim! Një falënderim i veçantë dhe special për 'Skifterat', për mbështetjen dhe miqësinë që më keni dhuruar. SC Gjilanit i uroj suksese dhe arritje të objektivave", ka shkruar Frashëri. Krahas mbrojtësit Frashëri, nga skuadra e Gjilanit është larguar edhe mbrojtësi i krahut të majtë, Jackson Ferreira.



Joshua: Karrierës time po i vjen fundi

LONDËR, 8 JANAR - Boksieri britanik Anthony Joshua, kampion bote në peshën e rëndë, ka deklaruar se brenda pesë vjetëve ai do të tërhiqet nga sporti. Aktualisht 31 vjeç, Joshua mban titujt e kategorive

IBF, WBA dhe WBO. Këtë vit ai pritet të duelojë dy herë ndaj Tyson Furyt, që mban titullin e kategorisë WBC në peshën e rëndë. Joshua është gjithashtu kampion olimpik, teksa ka fituar medaljen e artë në "Londër

2012". Ai ka një rekord prej 24 fitoresh e 1 humbje në karrierë. "Jam 31-vjeçar dhe natyrisht që karriera ime është drejt fundit. Unë gjithnjë e planifikoj të ardhmen time dhe shoh se po shkoj drejt fundit të saj", ka

thënë Joshua. "Mendoj se karriera ime do të zgjas sa një cikël olimpik, pra 4-5 vjet. Kur të zhvillohet olimpiada e ardhshme (Paris 2024) atëherë do të vijë edhe fundi i karrierës time", ka shtuar Joshua.



Drenica rikthen Ukën, Rogovën e merr nga Vëllaznimi

SKENDERAJ, 8 JANAR - Skuadra e Drenicës nga Skenderaj të premtën ka vazhduar të përforcohet për sezonin pranveror. Bëhet fjalë për dy sulmuesit Kreshnik Uka dhe Dardan Rogova. Sulmuesi Uka është rikthyer në skuadrën kuqezi, kurse Rogova për herë të parë do të djersijë fanellën e klubit nga Skenderaj. "Sulmuesi vendas Kreshnik Uka ka ardhur në formë huazimi për gjashtë muaj nga FC Prishtina, me mundësi vazhdimi. Ukën e njohim të gjithë, dhe ai do t'i ndihmojë skuadrës për stinorin pranveror. Ai luan në pozitën e sulmuesit të krahut dhe që nga dita e premtë është vënë nën 'urdhurat' e trajnerit Bledar Devolli. Ndërkohë, edhe një sulmues tjetër zbarkon në Drenicë. Fjala është për ish-sulmuesin e Besës dhe, së



fundmi, Vëllaznimit, Dardan Rogova. Ky i fundit është sulmues krahu dhe ka filluar menjëherë stërvitjet me grupin", thuhet në njoftimin e KF Drenica. Drejtuesit e klubit nga Superliga janë zotuar se shumë shpejt do t'i zyrtarizojnë edhe marrëveshjet me disa futbollistë të tjerë të spikatur

që do ta përforcojnë skuadrën për pjesën pranverore të kampionatit në Superligë. Të enjten Drenica ka prezantuar dy përforcimet e radhës në afatin kalimtar të janarit, qendërmbrojtësin Eglantin Gjonin i cili, së fundmi, ka qenë pjesë e Llapit dhe mesfushorin Donald Rapo që ishte pjesë e Laçit në Shqipëri.

San Antonio mposhti Lakersat, Dallasi triumfoi kundër Denverit

LOS ANGELES, 8 JANAR - Los Angeles Lakersi pëson humbjen e tretë sezonale në NBA. Për ta ndalur hovin e kampionëve në fuqi që vinin pas katër fitoresh radhazi mendoi San Antonio Spursi që triumfoi me rezultatin 118-109 brenda në "Staples Center". LaMarcus Aldridge ishte ai që mori për dore skuadrën teksa koleksionoi në total 28 pikë, 5 rebounde dhe 3 asistime me skuadrën e Gregg Popovitchit që regjistroi suksesin e katërt në tetë takime. Te Lakersi spikati mbreti James me LeBronin që me 27 pikë, 6 rebounde dhe 12 asistime ishte më i miri mbi parket për kalifornianët, por pa mundur ta evitojë dot humbjen e skuadrës së tij. Regjistroi fitoren e pestë sezonale Brooklyn Netsi që mposhti skuadrën më të mirë të momentit në konferencën e Lindjes, Philadelphia 76ers, me shifrat 122-109. Në mungesë të dy yjeve të ekipit, Irvingu dhe Duranti ishin Harrisit dhe LeVertit



që morën për dore skuadrën njujorkeze duke realizuar në total 50 pikë. Një ndeshje vërtet spektakolare ishte ajo që u zhvillua në Colorado mes Denver Nuggetsit dhe Dallas Mavericksit me skuadrën teksane që fitoi me shifrat 124-117 pas kohës shtesë. Slloveni Luka Donçiq e fitoi derbin ballkanas ndaj serbit Nikola Jokiç. Donçiq e mbylli ndeshjen me 38 pikë, 9 rebounde dhe 13 asistime duke iu afruar shumë triple-double, ndërkohë që

Jokiç koleksionoi në total 38 pikë, por edhe 11 rebounde dhe 4 asistime. Për Dallasin kjo ishte fitorja numër katër në tetë takime, ndërkohë që Denveri pësoi humbjen e 5-të në po kaq ndeshje. Buzëqeshi edhe Portland Trail Blazersi që u rikthye te fitorja falë suksesit 135-117 ndaj Minnesota Timberwolvesit në një sfidë ku Damian Lillard ishte fenomenal me 39 pikë, 7 topa të rikuperuar poshtë tabelës dhe 7 pasime deçizive.

Pochettino e dëshiron Agueron në PSG

Trajneri Mauricio Pochettino dëshiron që ta transferojë Sergio Agueron te Paris Saint-Germain, sipas agjentit të futbollit Bruno Satin. Satin ka thënë për Canal+

që trajneri i ri i kampionit francez e ka prioritet blerjen e argentinasi në mënyrë që ta përforcojë edhe më shumë fazën e sulmit. Pasi Neymarit dhe

Kylian Mbappe shpesh spekulohet se do të largohen, ardhja e Agueros do të sillte stabilitet dhe përvojë në sulmin e parisienëve.

SHKURT

Mustafi mund t'i bashkohet Interit

Futbollisti i Arsenalit, Shkodran Mustafi, është kthyer në njërin prej emrave më të përfolur në afatin kalimtar të janarit. Teksa mbrojtësi me origjinë shqiptare është piketuar si një alternativë në prapavijë për Barcelonën dhe Bayern Munchenin, këtë herë emri i tij është përmendur në lidhje me Interin. Media pranë klubit zikaltër, "FcInternews.it", shkruan se 28-vjeçari i "Topçinjve" i është ofruar klubit të famshëm italian. Dëmtimi i Danilo D'Ambrosios dhe mungesa për një kohë të gjatë i ka vënë në lëvizje drejtuesit e Interit për të menduar për një lojtar stoli në linjën e prapavijës. Mustafi është përfolur se do të largohet nga Arsenalit teksa në sezonin e fundit po aktivizohet edhe më pak.

Messi ndryshon mendje, gati ta përfundojë karrierën te Barça

Leo Messi tani është i lumtur dhe mund të qëndrojë deri në fund të karrierës në skuadrën e Barcelonës. Kështu raporton e përditshmja katalunase "Sport". Gazeta bën me dije se Messi po mendon seriozisht ta rinovojë kontratën me Barcelonën, e cila skadon në qershor. Duke citur burime pranë sulmuesit argjentinas, e njëjta gazetë shprehet se pas fitores së fundit kundër Bilbaos, ku "Pleshti" shënoi edhe dy gola, ai ka kuptuar se projekti i ri i Barcelonës mund të funksionojë. Po ashtu, Messi është i kënaqur që të dy kandidatët për president të Barcelonës e kanë vendosur atë në krye të agjendës së tyre menjëherë sapo ta marrin postin. Në këtë mënyrë, e ardhmja e Lionel Messit do të jetë sërisht me skuadrën katalunase, pavarësisht prej ofertave të "çmendura" të Manchester Cityt dhe Paris SG.

Blatteri në gjendje të rëndë shëndetësore

Zvicerani ishte një nga figurat më të diskutueshme të futbollit gjatë epokës së tij në krye të FIFA-s. Sepp Blatter ka dalë në pension prej disa vitesh, por tani është përsëri në faqet e para të mediave për shkak të problemeve shëndetësore. Ai është shtruar me urgjencë në spital. 84-vjeçari shërbeu si sekretar i përgjithshëm i FIFA-s, pastaj zëvendësoi si president Havelange, duke e mbajtur atë karrige për 17 vjet, nga 1998 deri më 2015, kur u detyrua të jepte dorëheqje pas skandalit të korrupsionit që përfshiu organin më të lartë të futbollit botëror, me shtatë drejtues të arrestuar. Blatteri është në gjendje të rëndë në spital, por nuk i kërcënohet jeta, siç dëshmohet nga vajza e tij Corinne, për "Blick": "Presim të bëhet më mirë çdo ditë, por i duhet kohë dhe pushim". Arsyet specifike që çuan në shtrimin në spital të ish-numrit një të futbollit botëror nuk janë zbuluar ende.

Kloppi: Nuk do të ketë transferime në janar

Skuadra e Liverpoolit është prekur nga dëmtimet e shumta këtë sezon. Situata më problematike është krijuar në prapavijë, aty ku Kloppi ka humbur për shkaqe dëmtimesh emra si Virgil Van Dijk, Joe Gomez dhe Joel Matip. Kampionët e Anglisë kanë nevojë për një qendërmbrojtës teksa në takimin e fundit në kampionat përballë Southamptonit (Liverpool humbi 1-0), trajneri gjerman luajti me dyshen Henderson-Fabinho (të dy mesfushorë) në qendër e repartit defensiv. Tifozët presin përforcime në merkaton e dimrit, por Kloppi deklaroi se një gjë e tillë nuk do të ndodhë. "Nuk mund ta them me siguri të plotë që nuk do të bëjmë asnjë blerje tani, por thjesht nuk është e mundur në këtë situatë. Edhe nëse do të bashkohet ndonjë lojtar më ne, që nuk e di a do të ndodhë, nuk e cilësoj si një zgjidhje të drejtë, pasi koha është e shkurtër për t'u përshtatur dhe vështirë që do të na ndihmonte", ka deklaruar Kloppi.



Nr: 01/2021
Tarih:09.01.2021

03/L-212 nolu Çalışma Yasasının 8. Madde, 04/L-032 nolu Kosova Cumhuriyeti Üniversite Öncesi Eğitimi Yasasının 04/L-032 sayılı kanunu 35. madde, 03/L-068 nolu Kosova Cumhuriyeti Belediyelerinde Eğitim Yasası 5. madde, TEBB 10/2018 sayılı idari talimatlarına göre (Genel Eğitim Mesleki Çerçeve Yönetmeliği), Kamu sektöründe iş ilişkilerinin kurulması için prosedürleri düzenlemek için 07/2017 nolu İT göre Mamuşa Belediyesi, Eğitim Müdürlüğü aşağıdaki konkuru ilan etmektedir:

KONKUR

Boş Çalışma Yeri tamamlamak İçin Türk Dilinde

Mamuşa-da İlk ve orta alt "ANADOLU" okulu

Kimya dersi öğretmeni 18 ders

İş sözleşmesi: Belirsiz zamanda

Adaydan istenilen şartlar;

Koşullar – Boş çalışma iş yerleri için uygun mesleki yeterlilik gereklilik TEBB 10/2018 sayılı idari talimatlarına göre (Genel Eğitim Mesleki Çerçeve Yönetmeliği).

Konkur için gerekli belge

Aday tarafından doldurulmuş başvuru formu (istem) (BEM 10 no'lu ofisinde alınır)
Diploma kopyası, onaylatılmış şekilde
-Aday ülke dışında mezun olmuş ise Eğitim Bakanlığında diploma denkliliği
Profesyonel Seminer Sertifikası, TEBB öngördüğü ve desteklediği
Doğum belgesi,
Kimlik kopyası,
Adayın herhangi bir suç, şiddet veya başka bir suçtan mahkum edilmediğine dair belgelendirme.
Adayın sağlık sertifikası (adayın işe kabul edilmesi durumunda getirilmesi zorunludur)

Başvuru formu Belediye Eğitim Müdürlüğü'nden alınarak, aranan tüm evraklar ile birlikte Belediye Eğitim Müdürlüğü'ne teslim edilmektedir.

- Tamamlanmamış belgeler ve son tarihten sonra gelenler komisyon tarafından dikkate alınmaz
Konkur gazetede ilan edildiği günden itibaren 15 gün açık kalacaktır.
Not: Konkur için tamamlanmış dokümanlar adaylara iade edilmeyecektir.

Mamuşa Belediyesi



Nr.:01/2021
Data: 09.01.2021

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212 nenit 35 Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës nr 03/L-068,U/A nr 10/2018(Normativit mbi kuadrin Professional të arsimit të përgjithshëm) U/A nr 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komonale e Arsimit në Mamushë shpall këtë:

KONKURS

Për plotsimin e vendit të lire të punës Në gjuhën turke

SH.F.M.U "ANADOLU" në Mamushë

1 (një) Mësimëdhëns KIMIA 18 orë

Kontrata e punës: në kohë të pacaktuar

kushtet e kërkuara nga kandidatët

Kushtet: - Për vendin e lire të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimeve Administrative nr 10/2018 të MASHT-it (Normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm).

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim

Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati (merret në DKA zyra nr.10)
Kopjen e diplomës të vërtetuar (noterizuar) Nostrifikimin e diplomës nëse kandidati e ka të kryer shkollimin jashtë Kosovës(kopja e vendimit nga MASHT- për nostrifikim).
Çertifikatë e seminarit profesional e përkrahur dhe e paraparë me MASHT (nëse ka) .
Certifikatën e lindjes.
Kopjen e letërnoftimit.
Vërtetimin se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepra penale tjera.
Çertifikata mjekësore e kandidatit (është e obligueshme të sillet me rastin e pranimit të kandidatit në punë)

Aplikacionet merren në DKA dhe dorëzohen të plotësuar së bashku me dokumentacionin e kërkuar në DKA.

- Dokumentet e pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga ana e komisionit.
Konkursi mbetet i hapur **15(ditë)** nga dita e shpalljes së konkursit në gazetë.
Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk ju kthehet kandidatëve.

Drejtoria e Arsimit
Komuna e Mamushës



Br: 01/2021
Datum: 09.01.2021

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br. 03 / L-212 Član 35 Zakona o pred-univerzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br. 04 / L-032, član 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br. 03 / L-068, A U br. 10/2018 (Normativ o stručnom osoblju opšteg obrazovanja) A U br. 07/2017 za regulisanje procedura za zasnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, opštinska Direkcija za obrazovanje u Mamuši po objavljuje ovaj:

KONKURS za slobodna radna mesta

Na Turskom nastavnom jeziku

Osnovna i niža srednja škola "ANADOLU" u Mamuši

1.Nastavnik . HEMIJA 18 čas.

Ugovor o radu: na neodređeno vreme

Uslovi

Uslovi: - Za upražnjeno radno mesto potrebna je odgovarajuća profesionalna kvalifikacija, prema Administrativnim uputstvima br. 10/2018 MONT-a (Normativ o stručnom osoblju opšteg obrazovanja).

Ne kvalifikovana dokumenta neće se uzeti u razmatranje.

Forma aplikacije pupunjena od strane kandidata(koja se uzima u kancelariji ODO br.10
-Kopija diplome ili sertifikata kao dokaz da je diplomirao/la.
Nostrifikacija diplome ako je kandidat završio školovanje van Kosova.
Potvrda radnog staža.
Profesionalno usavršavanje (seminari).
Izvod rođenih.
-Kopija lične karte.
Uverenje da kandidat nije osuđen za kriminal,silu ili druga dela.
Uverenje o zdravstvenom stanju samo kandidat koji bude primljen na radno mesto.

Popunjen zahtev zajedno sa zahtevanom dokumentacijom predati u kancelariji ODO br.10

Nepotpuna dokumentacija neće biti razmatrana od strane komisije.
Konkurs ostaje otvoren 15 dana:
Napomena: Dokumentacija za učešće na konkursu ne vraćaju se kandidatima.

Direktorijat Prosvete
Opština Mamusa



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

